

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**, Gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarve: Sh. (Z.) O., B. (Rr.) Gj. dhe A. (P.) M. për shkak të veprës penale Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së, si dhe kundër të akuzuarve: I. (Rr.)V., R. (I.) L. dhe R. (B.) H. të gjithë nga Komuna e P., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 dhe 25 të KPK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.439/2011 e dt.07.02.2011, e ndryshuar dhe zgjeruar me datë 23.02.2016, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë me datë 27.07.2016, në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë Fatmir Behrami dhe të akuzuarve I. V., R. H. dhe R. L., e në mungesë të dëmtuarit H. K., në të njëjtën ditë, mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 03.08.2016, përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit,

**1.SH. O.**, i biri i Z. i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin Ll., me vendbanim në P., rruga “...” nr. ..., i pa punë, me nr. personal: *numër personal...*, nuk ka qenë i gjykuar më parë, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së,

## REFUZOHET AKUZA

### Sepse:

Me datën 27.01.2011 rreth orës 19:30 në Podujevë në rrugën “...” në bastoren sportive “Ll. S.”, i pandehuri Sh. O. nga të pandehurit D. K. dhe I. V. ka blerë në çmim prej 600 euro, 1 televizor plazma, me ngjyrë të zezë, 1 DVD “Samsung”, me ngjyrë të zezë, 1 aparat të kafes “Saeko-Odea”, me ngjyrë të portokalltë dhe të hirit, 1 fshesë elektrike “Lion”, me ngjyrë të gjelbër dhe të zezë, 1 digitron të televizorit plazma, 1 mbajtës të televizorit plazma me ngjyrë të zezë, 2 tavolina të vogla 60x60cm me xham me dru, 1 komplet gotash me bakall 6x1, 1 komplet filxhanash 6 copa, 14 lugë ushqimi të metalta, 7 thika të bukës të metalta, 1 adapter mbushës elektrik i televizorit “Nokia”, 1 stoli dekorative, edhe pse e ka ditur se të njëjtat janë siguruar me kryerjen e veprës penale të vjedhjes, pronë e të dëmtuarit H. K.,

Me këtë kishte për të kryer veprën penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par. 1 të KPK-së.

Për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale i arritur me datën 27.01.2015, në kuptim të nenit 91 par.6 të KPK-së.

Ndaj të pandehurit,

**2.B. GJ.**, i biri i Rr.it, i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin D. e P., ku edhe jeton, me nr. personal: *numër personal...*, nuk ka qenë i gjykuar më parë, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **REFUZOHET AKUZA**

#### **Sepse:**

Me datën 27.01.2011 rreth orës 13:00 në Podujevë, i pandehuri B. Gj. nga të pandehurit D.K. dhe B. H. ka blerë, 1 bocë të plinit të metalt, me ngjyrë portokalli në sasi prej 20 litrave, 2 boca të plinit të metalt me ngjyrë të bronzitë, në sasi prej 4 litrave, 3 copa tava të aluminit, 2 kompleta gjygyma, 2 tepsia të aluminit, 1 gyp i bocës së plinit me ngjyrë të zezë, edhe pse e ka ditur se të njëjtat janë siguruar me kryerjen e veprës penale të vjedhjes, pronë e të dëmtuarit H. K.,

Me këtë kishte për të kryer veprën penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par. 1 të KPK-së,

Për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale i arritur me datën 27.01.2015, në kuptim të nenit 91 par.6 të KPK-së.

Ndaj të pandehurit,

**3.A. M.**, i biri i P., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin D. e P. ku edhe jeton, me profesion - bujk, me nr. personal: *numër personal...*, i gjykuar për vepër tjetër penale e i cili gjendet në vuajtje të dënimit, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **REFUZOHET AKUZA**

#### **Sepse:**

Me datën 29.01.2011 rreth orës 12:00 në Podujevë në tregun e druve, i pandehuri A. M. nga i pandehuri D. K. ka blerë në çmim prej 55 euro këto gjësende: 1 tepih ngjyrë krem me dimensione 280x2 metra, 1 tepih ngjyrë të kaltër me dimensione 280x2 metra, 1 tepih me ngjyrë të portokalltë me dimensione 280x2 metra, 1 tavolinë druri me xham me dimensione 1m x 50cm, 1 karrocë dore me ngjyrë të gjelbër, edhe pse e ka ditur se të njëjtat janë siguruar me kryerjen e veprës penale të vjedhjes, pronë e të dëmtuarit H. K.,

Me këtë kishte për të kryer veprën penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par. 1 të KPK-së,

Për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale i arritur me datën 29.01.2015, në kuptim të nenit 91 par.6 të KPK-së.

Ndaj të akuzuarve:

**4.R. L.**, i biri i I. dhe nënës N., e vajzërisë G., i lindur më datë *data e lindjes...*, i lindur në P. tani me vendbanim në fshatin B., KK P., me nr. personal: *numër personal...*, ka të kryer Shkollën e Mesme, me profesion Kamarier, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, baba i një fëmiju, më parë i gjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**5.R. H.**, i biri i B. dhe nënës R., e vajzërisë Q., i lindur më datë *data e lindjes...*, i lindur në P. tani me vendbanim rruga "...” KK P., me nr. personal: *numër personal...*, ka të kryer Shkollën e Mesme, me profesion Kamarier, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa martuar, baba i një fëmiju, më parë i gjykuar, gjendet në vuajtje të dënimit, ndaj tij zhvillohet procedurë tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPPRK-së,

## REFUZOHET AKUZA

### Sepse:

Me qëllim që vetit t’i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, pas marrëveshjes paraprake me dt.18.01.2011 e deri më dt.30.01.2011, në vazhdimësi, në fshatin D., në shtëpinë e të dëmtuarit H.K., në bashkëveprim dhe me ndihmë, me përdorimin e forcës, me mjet të përshtatshëm - paiser, kanë hapur dritaren e shtëpisë së katit të parë, duke depërtuar në brendësi dhe nga aty kanë arritur të marrin 1 (një) televizor plazma, ngjyrë e zezë, 1 (një) DVD “Samsung”, ngjyrë e zezë, 1 (një) aparat të kafes “S.”, 1 (një) thithëse elektrike “L.”, ngjyrë e gjelbër, një digitron, një mbajtëse të televizorit, 3 (tri) tavolina, 1 (një) komplet gota filxhana, lugë, thika, 1 (një) adapter, 1 (një) figurë dekorative, 3 (tre) tepih, 1 (një) karrocë dore ngjyrë e gjelbër, 1 (një) ventilator “Trisa”, ngjyrë e zezë dhe hiri, dhe të gjitha këto i kanë vendosur në automjetin “Taxi” – “Opel Cadet”, të cilin e drejtonte i pandehuri I. V., i cili e ka ditur se më parë për marrëveshjen e kryerjes së veprës penale vjedhje e rëndë, i ka dërguar çdo herë dhe pritur në vendin e ngjarjes, derisa të pandehurit kanë kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë dhe i ka dërguar në vendet ku i kanë shitur gjësendet e vjedhura, me ç’rast tani të dëmtuarit H. K., i kanë shkaktuar dëm në vlerë prej 3.000 €.

Me këtë kishin për të kryer në bashkëkryerje veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Për shkak se prokurori i shteti është tërhequr nga akuza në shqyrtimin gjyqësor.

Ndërsa i akuzuari,

**6.I. V.**, i biri i Rr. dhe nënës B., e vajzërisë H., i lindur më datë *data e lindjes...*, në fshatin D. tani me vendbanim Lagja e "...", KK P., me nr. personal:*numër personal...*, ka të kryer Shkollën e Mesme, me profesion Taksist, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, baba i tre fëmijëve, më parë nuk ka qenë i gjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në kuptim të nenit 364 par. 1 pika 1.3 të KPPRK-së,

## **LIROHET NGA AKUZA**

### **Sepse,**

Me qëllim që vetit t'i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, pas marrëveshjes paraprake me dt.18.01.2011 e deri më dt.30.01.2011, në vazhdimësi, në fshatin D., në shtëpinë e të dëmtuarit H. K., në bashkëveprim dhe me ndihmë, me përdorimin e forcës, me mjet të përshtatshëm - paisjer, kanë hapur dritaren e shtëpisë së katit të parë, duke depërtuar në brendësi dhe nga aty kanë arritur të marrin 1 (një) televizor plazma, ngjyrë e zezë, 1 (një) DVD "Samsung", ngjyrë e zezë, 1 (një) aparat të kafes "Seiko", 1 (një) thithëse elektrike "Lion", ngjyrë e gjelbër, një digitron, një mbajtëse të televizorit, 3 (tri) tavolina, 1 (një) komplet gota filxhana, lugë, thika, 1 (një) adapter, 1 (një) figurë dekorative, 3 (tre) tepih, 1 (një) karrocë dore ngjyrë e gjelbër, 1 (një) ventilator "Trisa", ngjyrë e zezë dhe hiri, dhe të gjitha këto i kanë vendosur në automjetin "Taxi" – "Opel Cadet", të cilin e drejtonte i pandehuri I. V., i cili e ka ditur se më parë për marrëveshjen e kryerjes së veprës penale vjedhje e rëndë, i ka dërguar çdo herë dhe pritur në vendin e ngjarjes, derisa të pandehurit kanë kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë dhe i ka dërguar në vendet ku i kanë shitur gjësendet e vjedhura, me ç'rast tani të dëmtuarit H. K., i kanë shkaktuar dëm në vlerë prej 3.000 €.

Me këtë kishte për të kryer në ndihmë veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par. 1 pika 1 lidhur me nenin 25 të KPK-së.

Për shkak se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Kërkesë pasurore juridike nuk ka pasur.

Shpenzimet e procedurës penale dhe paushalle, bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

## **A r s y e t i m**

PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.nr.439/2011 e dt.07.02.2011, e ndryshuar dhe zgjeruar me datë 23.02.2015, kundër të akuzuarve: B. (F.) H., I. (Rr.)V., R. (I.) L. dhe R. (B.) H. të gjithë nga Komuna e P., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 dhe 25 të KPK-së dhe Sh. (Z.) O., B. (Rr.) Gj. dhe A. (P.) M. për shkak të veprës penale Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par 1 të KPK-së.

Gjykata lidhur me të pandehurit Sh. O., B. Gj. dhe A. M. për shkak të veprës penale Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par 1 të KPK-së, në shqyrtimin fillestar të datës 30.10.2015, me aktvendim ka konstatuar se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, andaj në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së, lidhur me nenin 90 par.1 nënpar.6 të KPK-së që është përcaktuar se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar dy vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një (1) vit burgim ose dënim me gjobë dhe me nenin 91 par.6 të KPK-së që është përcaktuar se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale), merret aktgjykim refuzues për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Prokuroria e Shtetit e ka ndryshuar dhe zgjeruar aktakuzën me datë 23.02.2016, ndaj të akuzuarve R. L. dhe R. H. dhe ka refuzuar kallëzimin penal pjesërisht ndaj të pandehurit D.K. për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par 1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, konform nenit 275 par.1 të KPK-së, duke theksuar se ndjekja penale bëhet sipas propozimit, me që i dëmtuari H. K. është familjar i të pandehurit dhe nuk ju ka bashkangjitur ndjekjes penale.

Gjykata sipas aktakuzës së ndryshuar dhe zgjeruar ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 31.03.2016, në prezencën e Prokurorit të Shtetit dhe të akuzuarve: I.V., R. L. dhe R. H., ndërsa ka munguar i akuzuari B. H. kundër të cilit gjykata ka lëshuar urdhëresë për sjellje me forcë për katër herë me radhë e që nga informatat zyrtare të policisë ka rezultuar çdo herë se i njëjti gjendet jashtë shteti, ashtu që me pëlqimin e palëve dhe me qëllim të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës penale ka marr aktvendim për veçimin e procedurës penale kundër të akuzuarit B. H..

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar e deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, të akuzuarit I. V., R. L. dhe R. H., u deklaruan të pa fajshëm për veprën penale për të cilën akuzohen.

Prokurori shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi: Teoria mbi të cilën është ngritur aktakuza është pjesërisht e qëndrueshme dhe kërkoj nga gjykata që provave të cilat u administruan gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, deklaratave të dëshmitarëve D. K. dhe Sh. O. të njëjtave t'ua falë besimin dhe të akuzuarin I. V.n ta shpall përgjegjës dhe ta dënoj sipas ligjit, ndërsa sa i përket të akuzuarve R. L. dhe R. H. nga provat të cilat u administruan në këtë shqyrtim gjyqësor nuk u vërtetua se të njëjtit kanë kryer veprë penale sipas aktakuzës e cila i vihet në barrë, e në mungesë të provave hjeku dorë nga ndjekja penale për veprën penale e cila u vihet në barrë, gjegjësisht vjedhje e rëndë neni 253 par. 1 pika 1 e lidhur me nenin 23 të KPK-së.

I akuzuari I. V. në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi: Nuk e pranoj fajësinë për këtë veprë penale për të cilën jam akuzuar nga se unë punoj si taksist qe 11 vite, kam shkuar në fshatin D. jam ndalur në rrugë, sendet të cilat i kanë sjellë kanë qenë B. dhe D., sendet kanë qenë të mbështjella me qebe të cilat nuk i kam parë dhe nuk e kam pasur idenë se këto sende kanë qenë të vjedhura, të cilat i kam bartur nga fshati D. deri në P. te lokali i Sh. O.t dhe kërkoj nga gjykata që të më liroj nga kjo aktakuzë dhe të më shpall të pafajshëm.

Gjykata mori aktgjykim refuzues për të akuzuarit R. H. dhe R. L., për shkak se prokurori i shtetit në mungesë të provave është tërhequr nga akuza gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata gjatë procedurës së provave ka dëgjuar dëshmitarin: D.K., Sh. O., B. Gj. dhe A. M., është lexuar deklarata e të dëmtuarit H. K., të dhënë në prokurori me dt. 14.01.2016 dhe janë lexuar listat e provave materiale të dt. 30.01.2011.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje penale këto prova gjykata konform nenit 8 dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura në shqyrtim gjyqësor që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegjeje vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara se nuk asnjë provë të vetme që vërtetojnë dyshimin e bazuar se i akuzuari I. V. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

D. K. i dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit në shqyrtimin gjyqësor deklaroi: vjedhja ka ndodhur nga data 18.01.2011 tri ditë rresht, të cilën e kam kryer me B. H., kam hyrë nga dritarja e cila ka qenë e hapur në krah në shtëpinë e mixhës tim H. i cili jeton në Zvicër, kemi marrë të gjitha sendet të cilat janë të përshkruara në aktakuzë, e kemi kontaktuar katër herë taksistin I. V., i cili ka qenë vetëm si taksist dhe e kemi paguar çdo herë nga 10 (dhjetë) Euro, me të cilin i kemi bartur sendet dy herë gjatë ditës dhe dy ditë tjera nga një herë dhe i kemi shitur te A., Sh. dhe B., të cilët nuk e kanë ditur se sendet janë të vjedhura, dhe ka theksuar se emra të tjerë të cilët i ka përmendur në deklaratën e dhënë në polici, siç janë R. –D. dhe I. V., ka qenë për shkak të presionit që më është bërë nga zyrtarët policor.

Sh. O. i dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit në shqyrtimin gjyqësor deklaroi: me dt. 27.01.2011 rreth orës 19:30 kam blerë sendet aq sa më kujtohet një televizor dhe një aparat të kafes nga D. K., të cilat mi ka sjellë me taksistin I. V. te lokali im, e të cilat sende janë zbritur nga vetura nga D. K. të cilit i kam ndihmuar edhe un.

B. Gj. i dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit në shqyrtimin gjyqësor deklaroi: data nuk më kujtohet saktësisht, ora nuk më kujtohet saktësisht, mirëpo ka qenë mëngjes rreth orës 10:00 në fshatin D. e P. kanë ardhur D. dhe B. në hekurishten time me një kolicë të dorës të cilët kanë pasur një thes me sende të dëmtuara dhe punëtori i cili ka qenë në hekurishte i ka matur sendet dhe i kemi paguar 6-8 Euro, dhe kanë tentuar për të na e shitur edhe një karrocë dore por kam refuzuar sepse kam menduar se është e shtëpisë së tyre dhe kërkojnë të jua kthejmë prapë.

A. M. i dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit në shqyrtimin gjyqësor deklaroi: me dt. 29.01.2011 rreth orës 12:30 kam qenë më vëllaun tim në Podujevë tek Zyra e Gjendjes Civile, ka ardhur D. dhe më tha kam një kolicë, një tavolinë dhe dy tepiha për me i shitë, dhe më tha a don t'i blesh, un i thash nëse janë të vjedhura nuk do t'i blej por i njëjti më tha se nuk janë të vjedhura, mi ka sjellë në shtëpi në mbrëmje vet i treti por nuk jam i sigurt me kënd ka qenë, ngase e njoh vetëm D. nga shkolla fillore ndërsa ata të tjerët nuk i kam parë asnjëherë, i kam blerë sendet në shumë prej 65 Euro dhe kam pasur për t'ia paguar edhe 15 Euro, I. V. e njoh vetëm si kojshi por nuk ka qenë atë natë.

Deklarata e lexuar në shqyrtimin gjyqësor e të dëmtuarit H. K. e dhënë në Prokurori me datën 14.01.2016, i cili veç tjerash ka deklaruar se: shtëpia ime e vjedhur gjendet në fshatin D. e P. Komuna e P., në të cilën nuk jeton askush nga familja ime ngase un jetoj me familje në Zvicër, koha se kur është vjedhë shtëpia ime nuk e di por pas 2-3 dite jam njoftuar përmes telefonit nga djali i vëllait B. K., i cili më ka njoftuar se është hapur dritarja mbrapa shtëpisë e cila gjendet në

katin e parë në kuzhinë të cilët kanë depërtuar në brendësi të shtëpisë dhe nga aty kishin arritur t'i marrin të gjitha sendet të cilat janë të cekura në aktakuzë. Të gjitha sendet e vjedhura më janë kthyer dhe nuk e di se a ka ndonjë send tjetër që më ka munguar. Nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi nga asnjë person.

Nga listat e provave materiale të dt. 30.01.2011 vërtetohet sendet të cilat janë të konfiskuara nga dëshmitarët B. Gj., A. M. dhe Sh. O. dhe i akuzuari I. V., e të cilat sende i janë kthyer të dëmtuarit H. K..

Gjykata pas shqyrtimit dhe administrimit të këtyre provave të lartcekura dhe dëshmitarëve të dëgjuar, si dhe të akuzuarve në shqyrtimin gjyqësor, nuk është provuar se i akuzuari I. V. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, ngase me asnjë provë të vetme nuk janë vërtetuar elementet e veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par. 1 pika 1.1 të KPK-së dhe as elementet e ndihmës nga neni 25 të KPK-së, ngase gjatë shqyrtimit gjyqësor nga deklaratat e dëshmitarit D. K. e dhënë nën betim është vërtetuar se i pandehuri I. V. nuk ka qenë në dijeni se sendet të cilat i ka transportuar si taksist nga fshati D. deri në P. kanë qenë të vjedhura, ngase të gjitha sendet janë vjedhur në shtëpinë e mixhës së dëshmitarit D. K. dhe për shërbimin si taksist i pandehuri I. V. është paguar nga 10 (dhjetë) Euro, si dhe nga të gjithë dëshmitarët është i njohur I. V. si taksist, i cili edhe vet ka deklaruar se punon si taksist që 11 vite.

Gjykata duke pasur në konsideratë nenin 7 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, ku përcaktohet se gjykata, prokurori i shtetit, dhe policia janë të detyruar që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimeve të ligjshme, dhe me përkujdesje të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit dhe në favor të tij, dhe bazuar në nenin 361 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, ku përcaktohet se gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor, dhe detyrohet të vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të nxirret përfundim nëse fakti konkret është provuar, si dhe bazuar në nenin 3 par. 2 të KPPRK-së, është përcaktuar se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të pandehurit. Andaj, në mungesë të provave gjykata për të akuzuarin I. V. ka marrë aktgjykim lirues në kuptim të nenit 364 par.1 nënpar. 1.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr në bazë të nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 363 dhe 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal**  
**Pka.nr.20/2011 të dt. 03.08.2016**

**Sekretare juridike**  
Mihrie Krasniqi-Sheholli

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Gazmend Bahtiri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.